



Ne bazë të nenit 14 dhe nenit 58 pika a), b), d), g) i), të Ligjit mbi Vetëqeverisjen Lokale nr.03/L-40 dhe në përputhje me nenin 6, 7, 8 dhe 9 të Ligjit nr.04/L-144 për dhënie në shfrytëzim dhe këmbimin e pronës së palujtëshme të Komunës, dhe nenet 11, 12, 13, 14, 15, 16, 17 dhe 18 të Kapitullit III të Rregullores së QRK-së Nr.23/2013 për Përcaktimin e Procedurave të Dhënies në Shfrytëzim dhe Këmbimit të Pronës së Palujtëshme të Komunës si dhe nenit 21 të Statutit të Komunës së Deçanit, Kuvendi i Komunës së Deçanit në mbledhjen e vet të mbajtur me dt.03.09.2015, bie këtë::

## V E N D I M

### PËR SHPALLJEN FITUESE TË OFERTAVE TË PËRZGJEDHURA PËR DHËNIEN NË SHFRYTËZIM AFATGJATË (99) VITE TË TOKËS NDËRTIMORE KOMUNALE ME KONKURS PUBLIK

#### I.

Merret Vendimi për SHPALLJEN FITUESE të ofertave të përzgjedhura për dhënie në shfrytëzim afatgjatë (99) vite të tokës ndërtimore në pronësinë komunale me konkurs publik, me qëllim të ndërtimit të lartë në qytetin e Deçanit, i cili përfshinë ngastrat në vijim: ngastra nr. **1014** në sipërfaqe prej 1649 m<sup>2</sup>, me kulturë ndërtesë dhe oborr, nr.**1073/1** në sipërfaqe prej 4343 m<sup>2</sup> me kulturë oborr, nr.**1096** në sipërfaqe prej 265 m<sup>2</sup> me kulturë ndërtesë, nr.**1097** në sipërfaqe prej 140 m<sup>2</sup> me kulturë ndërtesë, nr.**1098** në sipërfaqe prej 225 m<sup>2</sup> me kulturë ndërtesë, nr.**1294/1** në sipërfaqe prej 2725 m<sup>2</sup> me kulturë ndërtesë dhe oborr, si dhe Ngastra nr.**0941** në sipërfaqe 1083 m<sup>2</sup>, me kulturë gurishte, ngastra nr.**0944** në sipërfaqe 62 m<sup>2</sup> me kulturë shtëpi ndërtesë, ngastra nr.**1254-1**, me sipërfaqe 6420 m<sup>2</sup> me kulturë oborr, ngastra nr.**1255** me sipërfaqe 530 m<sup>2</sup>, ngastra nr.**1260** me sipërfaqe 70 m<sup>2</sup>, ngastra nr.**1261** me sipërfaqe 28 m<sup>2</sup>.

#### II.

Në shënimet vijuese janë të paraqitura ofertat e ofertuesve të përzgjedhur nga komisioni dhe të miratuara nga Kuvendi i Komunës të cilët shpallen fitues të çdo Lloti veç e veç:

#### LLOTI 1

**Ndërtimi i Objektit Banesor-Afarist B+P+5 në ngastrën kadastrale nr.1014/1, e evidentuar në certifikaten e pronësisë P.70505021-01014-0, Komuna Kadastrale Deçan, P:1/1000 (plani i situacionit), Zona e I(parë) në Deçan, në sipërfaqe prej 1649 m<sup>2</sup>- Hapësira në rrugën "Sali Çeku" afer Bankes Ekonomike;**

#### Shpallet fituese:

Oferta e përzgjedhur nga Komisioni dhe e miratuar nga Kuvendi.

Kompania "LIKA TRADE"

|                  |                           |                         |
|------------------|---------------------------|-------------------------|
| "Lika Trade" - % | e ofruar per komunën      | 21 %                    |
| Garazha-parkingu | 684 m <sup>2</sup> x 21%  | = 143.64 m <sup>2</sup> |
| Banim            | 4104 m <sup>2</sup> x 21% | = 861.84 m <sup>2</sup> |
| Afarizem         | 684 m <sup>2</sup> x 21%  | = 143.64 m <sup>2</sup> |

## **LLOTI 2**

Ndërtimi dhe Rregullimi Urban i Bllokut afarist dhe banesorë B+P+3 në ngastrën kadastrale nr.0941, e evidentuar në certifikatën e pronësisë P-70505021-00941-0, me sipërfaqe 1083 m<sup>2</sup> dhe nr.0944 e evidentuar në certifikatën e pronësisë P-70505021-00944-0, në sipërfaqe prej 62 m<sup>2</sup> Komuna Kadastrale Deçan, P:1/1000 (plai i situacionit), Zona e I(parë) në Deçan, – Hapësira te parkingu i postes.

**Shpallet fituese:**

**Oferta e përzgjedhur nga Komisioni dhe e miratuar nga Kuvendi.**

**Albert Shoshi – “Fidani L”**

**Albert Shoshi – “Fidani L” - % e ofruar per komunën 27.1 %**

Garazha-parkingu  $424.36 \times 27.1\% = 117.711 \text{ m}^2$

Banim  $1.565.49 \times 27.1\% = 424.247 \text{ m}^2$

Afarizem  $434.36 \times 27.1\% = 117.711 \text{ m}^2$

## **LLOTI 3**

Ndërtimi dhe rregullimi i Objektit Banesor-Afarist B+P+7 në ngastrën kadastrale nr.1294-1 e evidentuar në certifikatën e pronësisë P-70505021-01294-1 me sipërfaqe 2725 m<sup>2</sup>, Komuna Kadastrale Deçan, P:1/1000(plani i situacionit), Zona e I(Parë) në Deçan, Hapësira afer bankes NLB Prishtina.

**Shpallet fituese:**

**Oferta e përzgjedhur nga Komisioni dhe e miratuar nga Kuvendi.**

**Kompania “GOGAJ – AG”**

**“Gogaj AG” % e ofruar per komunën 21.1%**

Garazha-parkingu  $519.74 \text{ m}^2 \times 21.1\% = 109.665 \text{ m}^2$

Banim  $2943.05 \text{ m}^2 \times 21.1\% = 620.983 \text{ m}^2$

Afarizem  $936.53 \text{ m}^2 \times 21.1\% = 197.607 \text{ m}^2$

## **LLOTI 4**

Ndërtimi dhe rregullimi i Objektit Banesor-Afarist B+P+6 dhe B+P+7 në ngastrën kadastrale nr.1073-1, e evidentuar në certifikatën e pronësisë P-70505021-01073-1 me sipërfaqe 4343 m<sup>2</sup>, ngastra nr.1096-0 e evidentuar në certifikatën e pronësisë P-70505021-01096-0 me sipërfaqe 265 m<sup>2</sup>, ngastra nr.1097-0, e evidentuar në certifikatën e pronësisë P-70505021-01097-0, me sipërfaqe 140 m<sup>2</sup>, dhe ngastra nr.1098-0 e evidentuar në certifikatën e pronësisë P-70505021-01098-0, me sipërfaqe 225 m<sup>2</sup>, Komuna Kadastrale Deçan, P:1/1000(plani i situacionit), Zona e I(parë), Hapësira afer Gjykates ne Deçan..

**Shpallet fituese:**

**Oferta e përzgjedhur nga Komisioni dhe e miratuar nga Kuvendi.**

**Kompania “LIKA TRADE”**

**“Lika Trade” % e ofruar për Komunën 21%**

Garazha-parkingu  $877 \text{ m}^2 \times 21\% = 184.17 \text{ m}^2$

Banim  $5.750 \text{ m}^2 \times 21\% = 1,207.5 \text{ m}^2$

Afarizem  $877 \text{ m}^2 \times 21\% = 184.17 \text{ m}^2$

## LLOTI 5

Ndërtimi dhe rregullimi i Objektit Banesor –Afarist 2B+P+7 në ngastrën kadastrale nr.1254-1 e evidentuar në certifikatën e pronësisë P-70505021-01254-1 ,me sipërfaqe 6420 m<sup>2</sup>, ngastra nr.1260-0 e evidentuar në certifikatën e pronësisë P-70505021-01260-0, me sipërfaqe 70 m<sup>2</sup>, ngastra nr.1261-0 e evidentuar në certifikatën e pronësisë P-70505021-01261-0, me sipërfaqe 28 m<sup>2</sup> ngastra nr 1255 me sipërfaqe 530m<sup>2</sup> Komuna Kadastrale Deçan, P:1/1000 (plani i situacionit), Zona e I(parë) në Deçan, Hapësira në qendër të qytetit-Banesa e kuqe, ku lejohet kati i dyte bodrum per nevoja te parkingut te banoreve .

### Shpallet fituese:

Oferta e përzgjedhur nga Komisioni dhe e miratuar nga Kuvendi.

Kompania SH.P.K. “AGULLIMI- A” – Gjakovë

SH.P.K. “AGULLIMI- A” % e ofruar për Komunën 21%

Garazha + parkingu  $3807 \times 21\% = 799.47 \text{ m}^2$

Banim  $10.020 \times 21\% = 2104.2 \text{ m}^2$

Afarizem  $4725 \times 21\% = 992.25 \text{ m}^2$

### III.

Për të gjitha Llotet nga hapësira e ofruar në përqindje për Komunën nga ofertuesit së pari zbriten metrat katrorë të banuesve në banesat aktuale që do të rrënohen , qofshin ato për banim apo afarizëm dhe pjesa tjetër e mbetur e metrave katrorë do të zbërthehet në mjete financiare sipas Rregullores për Caktimin e Lartësisë së Taksave dhe Ngarkesave për Shërbimet Komunale dhe ato mjete do të derdhen në buxhetin komunal duke u bazuar në kontratat me ofertustë e përzgjedhur.

### IV.

Në dokumentet aneks të këtij Vendimi që do të ruhen në dosje janë: Listat e dorëzimit të ofertave nga ofertuesit, raportet e hapjes se ofertave nga komisioni si dhe raporti i vlersimit me procesin e përzgjedhjes së ofertës më të mirë.

### IV.

Për zbatimin e vendimit të Kuvendit të Komunës sipas Ligjit Nr.04/L-144 obligohet Kryetari i Komunës që të lidhë kontratë me të cilën përcaktohen të drejtat dhe obligimet e palëve kontraktuese.

### V.

Vendimi hyn në fuqi ditën e miratimit në Asamble.

### VI.

Me nga një kopje të vendimit do të paisen: MAPL për shqyrtim të ligjshmërisë, Kompanitë përzgjedhëse, Kryetari i Komunës dhe Arhivi.


01.Nr.VIII-2

Deçan,dt.03.09.2015

Kuvendi i Komunës së Deçanit:

Kryesuesi i Kuvendit:

Jashar Dobraj



Stamp and form from the Municipality of Deçan. The stamp includes the text: "HYRËSE-ILAZINA-PROSTOR", "REPUBLIKA E KOSOVES - RITP - KOSOVA", "REPUBLIQUE DE KOSOVA", "KOMUNARE DEÇANIT - OPŠTINA DEČAN - DEÇANI MUNICIPALITY". The form contains handwritten entries: "Nr. Prot. 21134", "Prot. No. 21134", "Data: 10-09-15", "Datum: 10-09-15". There is also a handwritten number "01" and a signature.